

Arun Tairi, PhD¹

UDC: 338.246.2:[616.98:578.834-036.21(497.7)]

**PASOJAT NGA COVID-19 DHE MASAT EKONOMIKE TË
NDËRMARRA NË RMV PËR ZBUTJEN E KRIZËS**

**ПОСЛЕДИЦИТЕ ОД КОВИД-19 И ЕКОНОМСКИТЕ МЕРКИ
ПРЕЗЕМЕНИ ВО РСМ ЗА УБЛАЖУВАЊЕ НА КРИЗАТА**

**THE CONSEQUENCES OF COVID-19 AND THE ECONOMIC
MEASURES TAKEN IN RNM TO MITIGATE THE CRISIS**

Abstract

The COVID-19 pandemic presented itself as a new, previously unheard of epidemic and infectious disease, spreading throughout the world in the fastest possible form and causing millions of casualties, at which time almost the entire population was infected at least once by the virus. Both in the global economy and in the country's economy, the ratio between supply and demand for goods and services in various fields was unbalanced, as production was reduced and consumer incomes and resources were reduced. They were provided. The pandemic crisis, as an unprecedented form and with a rapid evolution, created a large number of essential challenges even for the most developed economies as well as the country, considering our low-income country, with a limited budget, there were many difficult to cope with the demand for health services, make quick decisions and provide relief to the economic sector as one of the most affected after the health sector. We have analyzed the impact of the COVID-19 pandemic, the effects and consequences it has brought in: the health, economic, educational sectors, in businesses, in banking institutions and beyond, at the same time we have elaborated the importance of fiscal and monetary economic measures, as well as the health measures of which were approved by the Government of the Republic of North Macedonia to help both economic entities and citizens

Keywords: *COVID-19, fiscal policy, monetary policy, government spending, macroeconomic indicators.*

¹ Profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës

Fillimi i shfaqjes së krizës COVID-19

Epidemia COVID-19 nuk është fatkeqësia e parë natyrore që ka prishur papritur zinxhirin global të furnizimit. Fatkeqësi të tjera natyrore, duke përfshirë tërmetin e vitit 2011 në Japoni, cunami indonezian i vitit 2004 dhe shpërthimi i SARS-it në Kinë në vitin 2003, çuan në një mungesë të prodhimeve të nevojshme. Megjithatë, ndikimet e këtij virusi janë të ndryshme në lidhje me shtrirjen dhe ashpërsinë e tyre. Gjatë muajve të fundit, ky virus infektiv është përhapur anembanë globit, duke dërguar miliona njerëz në kycje dhe në ruajtjen e distancimit fizik.² Pandemia e kohës e emëruar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si COVID-19, paraqitet si epidemi për herë të parë në Kinë, më saktë në kryeqytetin Wuhan, u shfaq si pneumoni e pa kaluar ndonjëherë nga popullata, duke mos njohur arsyen e infektimit dhe duke bartë simptomat e cilat shkaktonin vështirësi në frymëmarrje dhe shoqëroheshin me lodhje, plogështi dhe temperaturë, që ngjasonte me një grip të zakonshëm. Kështu, vetëm në fillim të janarit u konfirmua edhe viktima e parë e COVID-19, pikërisht në këtë vend. Sëmundja për një periudhë të shkurtër, filloi të përhapet pothuajse në të gjithë vendet, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u evidentua rasti i parë në fund të janarit, më pas në Spanjë, në Rusi, në Itali, në Mbretërinë e Bashkuar dhe për një kohë të shkurt gati 3 muaj përfshiu të gjithë Evropën dhe mbarë botën. Meqenëse ishte një sëmundje e re dhe nuk dihej shkaqet se nga vinte virusi, shumica e njerëzve mund të ishin të infektuar, por të pazbuluar si raste, të cilët mund të jenë pa simptomë virusi dhe me një imunitet më të fortë dhe nuk mund të dalloheshin nëse janë të prekur nga COVID-19, kjo situatë në mungesë të mosdijes, rëndon akoma më shumë gjendjen duke shtuar në të njëjtën kohë edhe më shumë numrin e të infektuarve. Transmetimi i parë lokal i virusit jashtë Kinës ndodhi në Vietnam nga babai te djali i tij, ndërsa transmetimi i parë lokal që nuk përfshinte familje ndodhi në Bavari edhe atë në Gjermani në 22 janar kur një bavarez kontaktoi sëmundjen nga një vizitor kinez në një takim biznesi në Gjermani.³ Duke qenë se shtimi i rasteve të reja ishte si pasojë e lëvizjes së personave nëpër vendet e botës, të cilat ishin qendra të virusit ku përhapja e tij ishte në përmasa më të mëdha, pikërisht në këto vende u ndaluan hyrjet dhe daljet si dhe çdo lloj transporti tokësor dhe ajror, me qëllim të parandalimit të virusit. Në saje të specifikave dhe kompleksitetit të virusit për të vërtetuar gjendjen nëse një person është i infektuar ose jo, të gjithë laboratorët vendosën në dispozicion realizimin e testit PCR për të identifikuar çdo person të prekur nga COVID-19.

² Yasheng Chen and Mohammad Islam Biswas, Turning Crisis into Opportunities: How a Firm Can Enrich Its Business Operations Using Artificial Intelligence and Big Data during COVID-19

³ <https://sq.wikipedia.org>

Pasojat nga kriza e pandemisë në Evropë dhe rrjedha globale

Edhe ekonomia botërore nuk ngeli immune nga goditja e krizës shëndetësore COVID-19 dhe duke qenë se vendet e zhvilluara kanë lëvizje më të madhe të popullatës dhe njëkohësisht këto vende janë më tepër të frekuentuara edhe nga turistët, Qeveritë e patën të patjetërsueshme të vendosin masa të rrepta duke mbyllur aeroportet dhe duke bllokuar linjat ajrore dhe jo vetëm, në mënyrë që situata të mos përkeqësohet edhe më shumë dhe të ruhet shëndeti i të gjithëve.

Sipas informacioneve nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, nga mesi i prillit, numri i të infektuarve në mbarë botën kaloi 1.800.000 njerëz - më shumë se 500.000 në Shtetet e Bashkuara, mbi 160.000 në Spanjë, 152.000 në Itali, 123.000 në Gjermani, 90.000 në Francë, 78.000 në Mbretërinë e Bashkuar, etj.⁴ Ndërsa sipas Worldometer, raste me koronavirus në mbarë botën deri në këto momente (30.07.2022) janë: raste aktive 622,503,532, persona të vdekur 6,547,569, dhe persona të shëruar 602,299,770.

Edhe zhvillimi ekonomik global nuk u përjashtua nga goditja e pandemisë COVID-19 e cila pas Kinës, kaploi të gjithë botën duke u pasuar me devijime në procesin zinxhirë të furnizimit global, zvogëlim të kërkesave dhe rënie ekonomike. E gjithë ekonomia botërore gjithashtu u ballafaqua me humbje të pashembullta, megjithëse në fillim të paraqitjes së pandemisë gjërat dukeshin më të thjeshta dhe askush nuk mendonte se e njëjta do të ecte me hapa aq të shpejt, mirëpo ndodhi e kundërta, ekonomia globale u përballë me rënie prej 3.5% duke arritur shifrën më të madhe që nga viti 1930. Në vitin 2020, bota regjistroi rritjen më të madhe të borxhit në nivel vjetor që nga Lufta e Dytë Botërore. Si rezultat i zvogëlimit të të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve, borxhi global u rrit në 226 trilionë dollarë ose sipas të dhënave të FMN-së, borxhi global u rrit për 28 pikë përqindjeje në 256 % të PBB-së në vitin 2020. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj rritjeje i takon borxhit publik, pasi borxhi publik global arriti rekordin prej 99% të PBB-së. Rritja e borxhit publik është veçanërisht e dukshme edhe në ekonomitë e zhvilluara, ku u rrit prej rreth 70% të PBB-së në vitin 2007 në 124 % të PBB-së në vitin 2020.⁵

⁴ Таки Фити, “Економската криза од ковид-19 и нејзините импликации врз македонската економија (како да ги ублажиме последиците од кризата?)”, МАНУ, Скопје 2021

⁵ finance.gov.mk

Tabela-1. Shtetet e botës me numër më të madh të rasteve të prekura nga COVID-19 (2022)⁶

Vendet	Rastet e përgjithshme	Vdekje të përgjithshme	Gjithsej të shëruar	Raste aktive	Popullsia
Bota	657,941,200	6,672,458	631,646,463	19,622,279	
Shtetet e Bashkuara	101,760,209	1,112,970	98,856,619	1,790,560	334,805,269
India	44,677,209	530,674	44,141,854	4,681	1,406,631,776
Franca	38,891,629	160,359	37,526,244	1,205,089	65,584,518
Gjermania	36,980,882	159,884	36,273,300	547,698	83,883,596
Brazili	35,914,141	691,854	34,542,868	679,419	215,353,593
Koreja	28,214,915	31,434	27,124,418	1,059,063	51,329,899
Japoni	27,187,394	53,499	20,933,870	6,200,025	125,584,838
Itali	24,884,034	183,138	24,215,242	485,654	60,262,770
Mbretëria e Bashkuar	24,089,042	198,271	23,798,674	92,097	68,497,907
Rusia	21,722,415	393,050	21,115,232	214,133	145,805,947
Spanja	13,651,239	116,658	13,444,388	90,193	46,719,142
Vietnam	11,523,161	43,180	10,610,290	869,691	98,953,541
Australi	10,975,374	16,692	10,546,102	412,580	26,068,792
Argjentina	9,766,975	130,041	9,593,883	43,051	46,010,234

Megjithatë, është e pranueshme që kriza COVID-19 çoi në perceptime të ndryshme qeveritare dhe një përgjigje përçarëse nga agjentët e BE-së. Daljet e saj hapën rrugën për një ndryshim në ekonominë politike të Eurozonës, me perspektivat e një bashkimi fiskal, rishpërndarjen dhe borxhin e përbashkët në nivelin mbikombëtar, përfundon Ladiand Tsarouhas (2020).⁷ Nevoja për vendosje të masave restriktive nga ana e autoriteteve si për lëvizje të popullsisë ashtu edhe për ndihmë financiare ishte e domosdoshme, për të zbutur efektet e krizës, dhe nga ana tjetër shohim edhe kundërefektet, pasi duke mbyllur bizneset dhe veprimtarit e ndryshme, zvogëluan si të ardhurat dhe

⁶ COVID Live - Coronavirus Statistics - Worldometer (worldometers.info)

⁷ Covid-19: A Different Economic Crisis but the Same Paradigm of Democratic Deficit in the EU, Dina Sebastião, Politics and Governance 2021, Politics and Governance (ISSN: 2183–2463) 2021, Volume 9, Issue 2, Pages 252–264

konsumin publik ashtu edhe kërkesën për mallra dhe shërbime. Në një situatë të tillë, duke u vështirësua gjendja kudo, shumë punonjës dhe emigrant u detyruan në forma të ndryshme të braktisin vendbanimet e tyre, për të kërkuar mundësi dhe punë të tjera nëpër vende të ndryshme.

Në përgjithësi, tregu i punës dhe ndërtimit u prek ndjeshëm gjatë valës së parë, veçanërisht në konsideratë të shkurtimeve të përkohshme dhe orëve të reduktuara dhe rreziku i të qenit subjekt i shkurtimeve të përkohshme ose orëve të reduktuara ka qenë pak mbi 20% në sektorin e ndërtimit gjatë Q2 2020.⁸

Efekti i pandemisë në investime dhe remitanca

Një rënie e konsiderueshme e remitancave gjatë COVID-19 do të ushtrrojë përkeqësim të mëtejshëm të kushteve të jetesës.⁹ Sigurisht, me zvogëlimin e të ardhurave si pasojë e krizës, u zvogëluua ndjeshëm perspektiva e rritjes, duke u zvogëluua në të njëjtën kohë edhe niveli i investimeve, remitanca të ulëta, zvogëlim në konsumim e mallrave dhe shërbimeve, duke e rritur gjithnjë e më shumë shkallën e varfërisë në çdo familje.

Remitancat globale parashikohet të bien ndjeshëm me rreth 20 për qind në vitin 2020 për shkak të krizës ekonomike të shkaktuar nga mbyllja dhe pandemia COVID-19. Dërgesat në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme parashikohet të bien me 19.7 për qind në 445 miliardë dollarë, duke përbërë një humbje të një linje jetësore financiare vendimtare për shumë familje.¹⁰ Lidhja e COVID-19 me globalizimin social është e rëndësishme pasi shumë vende vendosën kufizime të udhëtimit si për banorët ashtu edhe për udhëtarët e huaj. Mbyllja e kufijve pengoi migrimin e përkohshëm, veçanërisht lëvizjet e turistëve dhe studentëve të huaj brenda dhe jashtë vendeve. Remitancat e emigrantëve u prekën gjithashtu, jo për shkak të ndonjë kufizimi formal në dërgesat, por kryesisht për shkak të një goditjeje negative të tregut të punës në punësimin e emigrantëve. Ndikimi ka qenë më i theksuar, veçanërisht në vendet e zhvilluara, duke ulur numrin e remitancave që mund të riatdhesohen në vendet në zhvillim.¹¹

⁸ De Vet, J.M. et al. (2021). Impacts of the Covid-19 pandemics on EU industries. Publication for the committee on Industry, Research and Energy, Policy Department for Economic, Scientific and Quality of Life Policies, European Parliament, Luxembourg

⁹ Petreski, M (2021). Poverty during Covid-19 in North Macedonia: Analysis of the Distributional Impact of the Crisis and Government Response


¹⁰ Migration and Development Brief 32: Covid-19 Crisis through a Migration Lens, World Bank, 2020

¹¹ Binyam Afewerk Demena, Peter A.G. van Bergeijk and Sylvanus Kwaku Afesor-gbor: "COVID-19 the disease of inequality, not of globalization" Posted on March 3, 2022

Kriza e pandemisë në RMV dhe rajon

Virusi COVID-19 reflektoi efektin e tij negativ në të gjithë popullatën, e cila po mendohej të kuptojë në të vërtetë se, sa do të ketë ndikim kjo situatë në jetën e tyre, burimi i panjohur nga i cili mund të infektoheshin, dhe mundësia se si të përgjigjen në formë efektive ndaj kësaj gjendje të rënduar, si nga ana shëndetësore ashtu edhe psikologjike. Duke qenë se sektori i shëndetësisë ishte i pari që u ballafaqua me virusin, Qeveria e vendit që nga fillimi e në vazhdimësi është angazhuar duke miratuar masa të ndryshme shëndetësore gjatë gjithë kohës, pasi vendi u godit me disa valë radhazi të emëruara edhe me emra të ndryshëm nga organet kompetent. Në vendin tonë në kohën në të cilën janë siguruar të dhënat, d.m.th deri 01.10.2022, raste aktive me koronavirus ishin 342,775, numri i vdekjeve 9,534 dhe të shëruar 332,806 persona.

Grafiku 6. Numri total i rasteve në RMV ¹²



Vendet	Rastet totale të konfirmuara	Rastet e konfirmuara për 100.000 banorë	Gjithsej vdekje	Vdekje për 100.000 banorë
Bullgaria	211.813	3.040,3	8.483	121,8
Kroacia	225.128	5.325,0	4.655	110,1
Kosova	55.808	2.887,5	1.400	72,4
Mali i Zi	55.561	9.110,5	745	122,2
Maqedonia e Veriut	89.025	4.273,2	2.702	130,3
Serbia	372.533	5.312,7	3.750	53,3

¹² Worldometer (2022) Total Coronavirus Cases in the Republic of North Macedonia

Nga të dhënat e tabelës, e cila shfaq shifrat e rasteve të infektuara me COVID-19 dhe vdekjet në vendin tonë dhe rajon, vërejmë që Republika e Maqedonisë së Veriut është nga vendet e goditura më fortë në bazë të numrit të vdekjeve.

Kriza COVID-19 shkaktoi pasoja të rënda si për ekonominë e vendit, ashtu edhe për ekonominë e Ballkanit Perëndimorë, pasi në të njëjtën kohë pati rënie si nga oferta e përgjithshme ashtu edhe nga kërkesa agregate.

Goditja që mori sektori i ekonomisë nga pandemia COVID-19, është e konsiderueshme, shumica e bizneseve të prekura nga kriza ishin të obliguar të ndërpresin aktivitetin e tyre duke u mbyllur përfundimisht, pjesa tjetër që vazhduan hasën në vështirësi dhe humbje të mëdha. Sektori i gastronomisë dhe turizmit gjithashtu shënoi humbje nga masat e vendosura për të parandaluar virusin COVID-19, pati ndërprerje të punës së restoranteve, hoteleve, kafeneve, duke lejuar vetëm dërgimin e porosive në shtëpi, ku kjo formë e fitimit sigurisht ishte e vogël dhe e pamjaftueshme. Gjendja e tillë duke u dobësuar aktiviteti ekonomik, i solli bizneset në vështirësi financiare, zvogëlim në fuqinë punëtore dhe njëkohësisht të ardhura simbolike dhe të pamjaftueshme edhe për familjet e tyre.

Pjesa më e madhe e bizneseve në sektorët më të prekur kanë më pak se 50 të punësuar, përjashtim bën vetëm industria e veshjeve dhe tekstileve në Maqedoninë e Veriut ku firmat e vogla përbëjnë rreth 46 % të të gjithë bizneseve, ndërsa firmat e vogla në sektorët potencialisht të prekshëm përbëjnë mesatarisht 72 % të ekonomisë së Maqedonisë së Veriut në tërësi, 88 % në Serbi dhe Shqipëri, dhe 92 % në Mal të Zi.¹³

Shtetet fqinje u goditën gjithashtu fortë nga paraqitja e pandemisë COVID-19, duke humbur sasi të mëdha të ardhurash, me anulime të shumë prenotimeve në sektorin e turizmit, gjë e cila përkeqësoi dhe ndikoi drejtpërdrejti në ekonominë e këtyre vendeve.

Në Kosovë gjatë vitit 2020, si pasojë e krizës, bizneset paraqitën rënie në sektorin e ndërtimit, gastronomisë, turizmit, patën rënie prej 50 deri 100 për qind në shitje dhe fitimin e tyre, duke krahasuar aktivitetet e njëjta me vitin paraprak.

Edhe ekonomia e Shqipërisë e cila në nëntor të vitit 2019 u godit rëndë nga tërmeti duke shkaktuar pasoja të mëdha ekonomike dhe jo vetëm, u shoqërua më pas edhe nga pandemia, ku gjithashtu pjesa e firmave që raportoi rënie ishte më e madhe në sektorin e turizmit.

Pasojat nga COVID-19 në RMV

Pasojat shëndetësore dhe ekonomike në fillim të paraqitjes së virusit

Përderisa gjatë gjithë kohës, qytetarët dhe mbarë popullata kanë realizuar shumë aktivitete dhe punë të përditshme, për një moment gjithçka u ndryshua dhe mori kahje tjetër. **Shumë aktivitete ndaluan së vepruari, një**

¹³ <https://thedocs.worldbank.org>

numër i vogël i tyre pothuajse nuk janë prekur, një pjesë kanë zvogëluar në masë të caktuar punën e tyre, disa të tjera u mbyllën plotësisht duke larguar edhe fuqinë punëtore nga puna, për të mos i rikthyer sërish.

Pasojat negative të krizës së shkaktuar nga epidemia e virusit korona në ekonominë maqedonase u ndien në tremujorin e dytë të 2020, veçanërisht gjatë prillit. Kriza solli pasoja serioze negative, duke ndërprerë zhvendosje pozitive në dinamikën e rritjes ekonomike, ku rënia e aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2020 ishte - 12.7%, gjë që pritej, pas një rënie mbi 12%, në fushën e investimeve, në tregun e punës, në tregtinë e jashtme, në financa publike, në fushën e kërkesës së huaj për prodhimet maqedonase, etj.¹⁴

Qytetarët, konsumatorët dhe bizneset reflektuan dhe vazhdojnë të reflektojnë frikë për vendet e punës, paratë dhe investimet e tyre, ndërkohë që nga politika dhe qeveria kërkohet përgjegjshmëri dhe performancë maksimale në trajtimin e krizës dhe të efekteve të saj jo vetëm ekonomike, por sidomos sociale.¹⁵ Sigurisht, sektori më i goditur nga pandemia e COVID-19 është sektori i shëndetësisë, i cili pati goditje të paparashikueshme me humbjen e jetëve të miliona njerëzve në mbarë botën, jo më pak i goditur është edhe vendi ynë ku deri në këto momente (janar 2022) numri i viktimave arrin shifrën 8226.

Rasti i parë me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut u paraqit në kryeqytetin e Shkupit më 26 shkurt 2020, ku bartëse e virusit ishte një paciente pesëdhjetë vjeçare, e njëjta u izolua në Shkup, në Klinikën për Sëmundje Infektive.

Bluzat e bardha ishin personat të cilët vendosën në rrezik më shumë jetën e tyre, ata ishin në një formë të detyruar që përveç orarit të stërzgatur të punës, të përballen më shumë me mundësinë për t'u infektuar, meqë ishin gjatë gjithë kohës në kontakt me persona të sëmurë. Kjo situatë e palakmueshme, me përhapjen e shumë rasteve të reja çdo ditë e më shumë si dhe mungesa e një vaksine përkatëse, solli një rëndesë akoma më të madhe edhe në gjendjen emocionale dhe psikologjike të popullatës.

Pasi i gjithë globi u godit nga faktori joekonomik si COVID-19, viti 2020 ka qenë ndër vitet më të vështira përveç se nga ana shëndetësore, ashtu edhe nga ajo ekonomike për Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh, që, një vend i vogël me kapacitete dhe resurse jo të mjaftueshme për t'u konfrontuar me probleme të kësaj natyre, duke bashkangjitur edhe mungesën e një eksperience të pa kaluar më parë, bëri që vendi ynë, bashkë edhe me shumë vende të tjera të rajonit, një situatë të tillë ta përjetojnë me shumë vështirësi. Nga aspekti i aktivitetit ekonomik, i ndikuar nga tronditja e pandemisë, gjatë vitit 2020 janë vërejtur tendenca negative, të shprehura përmes përkeqësimit të aktivitetit të biznesit, që ka ndikuar në besimin dhe pritshmëritë e

¹⁴ Таки Фити, “Економската криза од ковид-19 и нејзините импликации врз македонската економија (како да ги ублажиме последиците од кризата?)”, МАНУ, Скопје 2021.


¹⁵ Ardian Civici, “Kriza Financiare...Apo Globale”, faqe 54

kompanive dhe konsumatorëve. Ekonomia e vendit në vitin 2020 shënoi një rënie reale prej 4.5%.¹⁶ Në të njëjtën kohë, pamundësia e kompanive për të përmbushur obligimet dhe nevojat e tyre, si në vend ashtu edhe jashtë, duke zvogëluar mundësitë e plasimit dhe konsumit të produkteve dhe shërbimeve në një treg të pasigurt, rezultoi edhe në zvogëlimin e kërkesës për të njëjtat, duke ndikuar edhe në zhvillimin e ekonomisë. Ishin të shumta sferat në të cilat pandemia la gjurmët dhe pasojat e saj, po nuk duhet anashkaluar disa sektor të tjerë të cilët COVID-19 solli edhe të hyra dhe përfitime. Pikërisht, institucionet bankare, supermarketet, barnatoret, laboratorët dhe spitalet private, ishin ata të cilët punonin gjatë gjithë kohës dhe siguronin shuma të mëdha financiare.

Masat e politikës fiskale dhe monetare të ndërmarra kundër Covid-19

Politika fiskale ishte ajo që reagoi në kohë duke marrë vendime për të mbështetur veprimtaritë e ndryshme, ndërmarrjet dhe punëtorët, kategori këto që më së shumti u afektuan nga COVID-19, me qëllim të zbusin efektet negative në lidhje me të ardhurat dhe buxhetin e tyre. Shpenzimet publike patën rritje të konsiderueshme për shkak të shumave të mëdha të cilat u adresuan në sektorin e shëndetësisë, shpenzimet për pushtetin lokal dhe shpenzimet për financimin e pagave.

Grafiku 1. Të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore dhe komponentët e tyre kryesor (% të PBB-së)¹⁷




Pandemia gjithashtu ndryshoi edhe nivelin e borxhit qeveritar, pothuajse në të gjitha vendet e botës me një rritje si asnjëherë më parë, edhe në vendin tonë nuk pati përjashtim duke e arrit shifrën e borxhit publik në 60% të PBB-së.

Grafiku 2. Gjendja e borxhit shtetëror dhe borxhit publik në milionë euro¹⁸

¹⁶ “Raporti Vjetor 2020”, Banka e Maqedonisë

¹⁷ “Raporti Vjetor 2020”, Banka e Maqedonisë

¹⁸ <https://finance.gov.mk>



Nga grafiku qartë mund të shohim se borxhi publik në vitin 2019 ishte 5,541 milionë euro, në vitin 2020 6,483 milionë euro, në vitin 2021 ishte 7,135 milionë euro dhe në gjysmën e parë të vitit 2022 arrin shifrën 7,227 milionë euro, pra kemi rritje të vazhdueshme përgjatë tre viteve. Ndërsa borxhi shtetëror në vitin 2019 ishte 4,557 milion euro, në vitin 2020 ishte 5,516 milion euro, në vitin 2021 ishte 6,080 milion euro, dhe në gjysmën e parë të vitit 2022 është 6,097 milion euro. Në kuadër të politikës monetare, në gusht të vitit 2020, Banka Popullore riaktivizoi ankandet e depozitave në valutë, gjë që në kushtet e pasigurisë në tregjet ndërkombëtare, u jep mundësi bankave në vend të vendosin një pjesë të mjeteve të tyre valutore në instrumente të sigurta dhe afatshkurtra të bankës qendrore. Vendosja e tillë e politikës monetare ka kontribuar në mbështetjen e flukseve të kredisë në ekonomi dhe në rritjen e likuiditetit në sistemin bankar, me një nivel solid të rezervave valutore dhe mungesë të presioneve inflacioniste.¹⁹

Masat monetare dhe fiskale afatshkurtra për përmirësimin e ndikimit social dhe ekonomik të COVID-19 në R.M.V janë:

- Mbështetje financiare direkte për të pranuar MSMS të cilët falimentuan për shkak të krizës COVID-19.
- Reduktim të normës së interesit nga Banka Qendrore në zbritje historike nga 2 në 1.75 %.
- Ndryshime të përkohshme për kushtet e kredisë.
- Reduktim në normat e interesit të dënimit për kompani dhe individ.
- Rifutje të kërkesës së rezervave jo standarde.
- Zgjatja e afatit për bankat do të paraqesin vlerësimin e tyre të brendshëm. Vlerësim për likuiditetin.

¹⁹ “Raporti Vjetor 2020”, Banka e Maqedonisë

- Heqja e tarifave për tërheqje dhe ripagimi i parave të gatshme për CB në valutë qendrore.

- Ngrirje e përkohshme e Riklasifikimit të NPL.

- Norma zero e interesit për kredi për SME-të të siguruara nga Banka e Zhvillimit.²⁰

Më 15 qershor të vitit 2021 u mbajt mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë Operative Monetare të Bankës Popullore, në të cilën u shqyrtuan zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare dhe vendore dhe treguesit për ekonominë vendase, në kontekst të pozicionimit të politikës monetare. Në mbledhje u vendos që norma bazë e interesit të mbetet 1,25 %, në mënyrë që politika monetare të ruaj natyrën e saj të relaksuar. Sipas treguesve të fundit makroekonomik për aktivitetin ekonomik, prodhimi i brendshëm bruto për tremujorin e katërt të vitit 2021 shënoi një rënie reale prej 1,9 % në bazë vjetore, në mes të një vale të tretë të COVID-19, e cila pati një ndikim negativ mbi dinamikën e rimëkëmbjes ekonomike.²¹ RMV-së si një vend i vogël me kapacitete dhe resurse jo të mjaftueshme dhe me një buxhet të limituar për t'u konfrontuar me probleme të kësaj natyre miratoi pakon e masave për zbutjen e krizës shëndetësore dhe ekonomike në të gjitha sferat ku ndikoi me më shumë pasojë, me shumën të konsideruara edhe atë;

- Pakoja e parë u miratua më 18 mars 2020

- Pakoja e tretë u miratua më 17 maj 2020

- Pakoja e dytë u miratua më 31 mars 2020

- Pakoja e katërt u miratua më 27 shtator 2020

- Pakoja pestë u miratua më 16 shkurt 2021

- Pakoja e gjashtë u miratua më 21 prill 2021

Conclusion

While trying to present a comprehensive panorama on various fields, I have managed to contribute additionally to the knowledge about: the impact of the COVID-19 pandemic on monetary and fiscal policies, as well as on various productive and service economic activities, on public institutions, the health system, the education system, private institutions and others.

²⁰ THE IMPACT OF COVID-19 ON LABOUR MARKET IN NORTH MACEDONIA Merita Zulfiu Alili, 2020

²¹ [https:// www.nbrm.mk/](https://www.nbrm.mk/)

The COVID-19 pandemic has been defined and named as a global health crisis and at the same time the biggest challenge we have faced since the Second World War.

Facing this global health crisis accompanied by a major economic and financial crisis brought great pressure to our society and, since it was something new and unforeseen before, the governments of the countries acted in an ad-hoc manner.

Such a situation was accompanied by the death of millions of people, the forced closing of firms - layoffs, numerous social distancing, growth and recession from different aspects, as well as many other obstacles and challenges.

With the breaking out of the pandemic, the authorities needed to take measures so they could paralyze the spread of the virus and protect the health of all citizens, above all the psychological health, which was aggravated to a high degree in the majority of the population. Of course, these restrictions on movement have dealt a blow to both society in general and the economy in particular, causing a recession in economic activity and a lack of investment in international trade. All of us as citizens, as institutions, businesses, etc., coexisted for an indefinite time with the pandemic, where in reality, it was a great and very serious threat to the entire community.

Recensentë:

Prof. dr. Safet Emruli

Prof dr. Afet Mahmuti

Literatura

- Ardian Civici, “Kriza Financiare...Apo Globale”, faqe 54
- Абдулменаф Беџети “Фискалните политики и фискалниот простор во време на глобалната пандемиа со посебен осврт на Република Северна Македонија”, ИСТРАЖУВАЧКИ АКТИВНОСТИ НА МАНУ ЗА НАДМИНУВАЊЕ НА ПАНДЕМИЈАТА НА КОВИД-19, Скопје 2020
- Almeida, V. (2021). The impact of Covid-19 on households’ income in the EU. The journal of Economic Inequality..
- Изет Зеќири “Бизнис-стратегии на фирмите во услови на ковид-19”, Ману, Скопје
- Petreski, M (2021). Poverty during Covid-19 in North Macedonia: Analysis of the Distributional Impact of the Crisis and Government Response

- Таки Фити, “Економската криза од ковид-19 и нејзините импликации врз македонската економија (како да ги ублажиме последиците од кризата?)”, МАНУ, Скопје 2021
- Yasheng Chen and Mohammad Islam Biswas, Turning Crisis into Opportunities: How a Firm Can Enrich Its Business Operations Using Artificial Intelligence and Big Data during COVID-19
- THE IMPACT OF COVID-19 ON LABOUR MARKET IN NORTH MACEDONIA Merita Zulfu Alili, 2020
- COVID Live - Coronavirus Statistics - Worldometer (worldometers.info)
- Raporti Vjetor 2020’’, Banka e Maqedonisë
- Worldometer (2022) Total Coronavirus Cases in the Republic of North Macedonia
- Enti shtetëror i statistikës së RMV-së
- <https://thedocs.worldbank.org>
- <https://finance.gov.mk>